



Kuvendi i Komunës Klinë

Debat me Publikun

01Nr 06-22781/23

Klinë,dt: 11.02 /23

PROCESVERBAL

Nga Debati me Publikun, mbajtur, më 27.06.2023, me fillim nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi, ku të pranishëm ishin kryetari i komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, nënkryetarja e komunës, znj. Marqe Tanushi-Selmanaj, drejtorë të drejtorive, zyrtarë tjerë komunalë, drejtori i OSBE-së dhe qytetarë të Komunës së Klinës.

RENDI I DITËS

1. Draft-Strategjia për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2026.

Fadil Gashi, kryesues: Përshëndetje, mirë se keni ardhur në këtë shqyrtim dhe konsultim me publikun! Unë ju falënderoj shumë, që ju jeni shpëputur nga aktivitetet e juaja për të ardhur bashkë me ne në këtë diskutim dhe këtë shqyrtim të përbashkët në një dokument të rëndësishëm, siç është Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026.

Bashkë me ne është kryetari i komunës, nënkryetarja, drejtorët e drejtorive dhe, pa humbur kohë duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore, ne i kemi hapat që i ndërtojmë në këtë kornizë, kemi ardhur në këtë shqyrtim pas debateve tjera që janë zhvilluar edhe nëpër terren edhe nëpër institucione të ndryshme. Është një dokument që, për nga rëndësia, gjithë puna e komunës së Klinës si organizatë buxhetore është e determinuar në këtë kornizë për vitet në vijim, prandaj edhe këto të takimeve edhe këto të dëgjimeve janë në vazhden e jo veç të transparencës, por edhe të bashkëpunimit të mirëfilltë në orientimin e planifikimeve që mendon t'i bëjë komuna e Klinës për territorin e vet edhe për kushte të caktuara.

Unë pa humbur kohë po ja kaloj fjalën për një prezantim, drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi,

Zhvillim dhe Financa, z.Enver Berisha.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues, i nderuar kryetar, z. Zenun Elezaj, nënkryetar, kolegë të punës, ju të pranishëm, qytetarë të komunës sonë!

Ashtu siç e tha kryesuesi dhe ashtu siç e parasheh edhe Ligji për Buxhetin, ne jemi të obliguar që për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të bashkëbisedojmë me bashkëqytetarë të komunës sonë dhe, ne, këtë fazë e kemi filluar që nga javët e kaluara dhe ato nëpër të gjitha lokalitetet e komunës sonë, ose më mirë me thënë nëpër të gjitha bashkësitë lokale. Kemi debatuar me qytetarin dhe në ato debate kemi biseduar për ato projekte që janë realizuar, për projekte që janë në realizim e sipër dhe për projektet që do të realizohen këtë vit në këtë pjesën e dytë dhe në vazhdimësi për projektet e ardhshme, kështu që, ne, në kuadër të kësaj e kemi bërë edhe planifikimin buxhetor për katër vite. Për ata që nuk kanë qenë në dijeni dhe për qytetarë që ndoshta mund të mos kenë informata sa duhet, por që mungojnë, sot është dashur me qenë prezencë më e madhe, me të vetmen arsye që ky buxhet që ne e hartojmë për çdo vit është buxhet që është në interesin e qytetarëve dhe është mirë ata të bëhen pjesë e realizimit dhe kërkesave tyre dhe projekteve tyre, mirëpo, ne do të vazhdojmë edhe me ju që jeni këtu dhe do të hartojmë buxhetin për vitet vijuese.

Në vitin aktual që jemi, buxheti total ka qenë 13,051,000,00 euro, që do të thotë që në këtë vit tash dmth buxheti ka qenë më i vogël sesa në 2024 që kemi planifikuar përrreth 700,000,00 euro, për 2024-tën do të jetë 14,798,718,00 euro, ky buxhet dmth është i shpërndarë në kategorinë brenda vetes që janë të hyrat vetanake; të hyrat vetanake janë te mjetet që i sigurojmë ne, dmth si komunë duke i shfrytëzuar dmth qiratë, bizneset, taksat, tatimet, etj., dhe ky buxhet është i planifikuar për vitin 2024 1,436,000,00 euro, që do të thotë se është përrreth 100,000 euro më shumë sesa vitin që po e kalojmë. Këto të hyra do të kthehen prapë në investime për nevojat e juaja si qytetarë të komunës sonë, ndërsa pjesa më e madhe e buxhetit që shpenzohet është në paga dhe mëditje, ky buxhet është 7,648,500,00 euro këtë vit, gjë që është përrreth 1,000,000,00 euro më i madh sesa vitin që jemi aktualisht, për faktin se me ligjin e pagave janë të gjitha kategoritë e pagave që janë rritur dhe mëditje, po ashtu, dhe ky buxhet është dukshëm më i madh sesa ka qenë në vitin aktual, po ashtu, kategoria tjetër është te mallra dhe shërbime që edhe këto janë për 100,000,00 euro më shumë sesa vitin aktual, nga 1,660,000,00 janë 1,710,000,00. Në kuadër të këtij kriteri janë pajisjet, nevojat që i ka komuna për të funksionuar, mandej si kategori tjetër janë shërbimet komunale, edhe këtu ka rritje nga 200,000,00 euro që kanë qenë të realizuara për këtë vit janë 250,000,00 për vitin 2024 për faktin se kanë ndodhur edhe këto shtrenjtimit e rrymës e tjera, dhe është dashur edhe ne si komunë me paraparë këtë rritje, dmth këtu paguhen komunalitë, rryma uji, mbeturina, është kategoria tjetër e subvencioneve që kryesisht janë në zyrën e kryetarit; këtë vit ka qenë 400,000,00 ndërsa vitin e ardhshëm janë të planifikuara 500,000,00 euro. Këtu hynë pagesat për ceremoni të varrimeve, për lindje, për sëmundje të ndryshme, për subvencione të bujqësisë edhe nevojat që janë të domosdoshme për zyrtarë që nga zyra e kryetarit mbulohen për shpenzime dhe kategoria e fundit është pjesa më kryesore, më e rëndësishme, janë projektet kapitale, në kuadër të saj dmth është një rritje, prej këtij viti në vitin 2024 është 700,000,00 euro, që është një rritje bukur solide dhe kjo ndodh për vitin 2025-2026 dhe pothuajse të gjitha këto kategori në një përqindje të caktuar tamam, rritet për çdo vit. Këto 4,690,000,00 që planifikohen për 2024 ne kemi marrë shumë orientime nga shumë kërkesa nga qytetarët për projekte që ata mendojnë për t'i realizuar vitin e ardhshëm dhe në vitet

vijuese, po kryesisht edhe pjesë që kanë qenë të përfshira në strategjinë zhvillimore dhe që do të jenë prapë.

Shumica e kërkesave të qytetarëve do të përfshihen edhe në strategjinë që jemi në aprovim e sipër, që jemi aktual dmth në planifikim që strategjitë zhvillimore me e aprovuar, ndoshta nëse mbërrimë brenda korrikut mirë, nëse jo, për mos me ardhur ne deri në seancën e shtatorit me u hartuar dhe strategjia zhvillimore. Prapëseprapë edhe ajo i sheh parametrat nëpër të cilat do të ecë komuna jonë. Kështu që, unë për fillim nuk kisha me e zgjatur më shumë, tash nëse dikush nga kryetari nuk e di a dëshiron ta marr fjalën apo drejtorët, por, nëse jo, atëherë jemi të gatshëm me i dëgjuar kërkesat dhe orientimet e juaja për planifikim të kësaj Kornize Afatmesme Buxhetore, faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor! Atëherë po hap debat për ju të pranishëm, po urdhëro, Zenun Zeqa?

Zenun Zeqa: Përshëndetje, kryetar, nënkryetare, kryesues, drejtorë dhe ju gjithë të pranishmit! Sot, në këtë takim me publikun, gjegjësisht me qytetarët e komunës së Klinës, kam dalë të marr pjesë dhe të paraqes propozim-kërkesë, e para është më e lehtë për ju të gjithë, ekzekutivin dhe për kuvendin; ka të bëjë me mosprishjen e shkollës së vjetër "Azem Bejta" në Grabanicë, e cila është punuar me material të fortë dhe është në gjendje shumë të mirë dhe ka mundësi që t'i plotësojë disa kërkesa të qytetarëve të bashkësisë lokale të Grabanicës. Besoj se ja kthejmë borxhin këtij mjedisi për shkak se pikërisht në atë mjedis është rezistuar dhe është ndër institucionet e rralla në ish-Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, që ka mbetur i pa luajtur emri i patriotit, Azem Bejta. Kështu që, kryetar, kryesues, nënkryetare edhe gjithë juve, jo propozim por kërkesë, në emër të qytetarëve, për shkak se që 33 vite kam folur në emër të tyre e sot po flas jo në aspektin politik, jo në aspektin partiak, po në aspektin shoqëror, t'i përfaqësojë gjithë ata, nëse është nevoja edhe nënshkrimet me i marr. Është një shkollë shumë e mirë që do t'i plotësojë kushtet, mirëpo të mos priset kjo, duke e pasur parasysh se do ta shfrytëzojmë, qoftë për nevojat e asaj ambulantes që është atje një vend të papërshtatshëm, qoftë zyre të gjendjes civile, qoftë edhe ndonjë institut tjetër aty, pse jo edhe dom të pleqve apo çerdhe të fëmijëve.

Propozimi i dytë apo kërkesa e dytë, edhe kjo është shumë e mirë edhe urgjente, ju e patë Bistrica e Pejës çka ka bërë veç para tri netëve edhe çka kanë bërë vërshimet vitin e kaluar edhe këtë vit, sa tokën e kanë prishur. Kështu që, kërkoj që edhe ky propozim të hyjë në rend të ditës edhe brenda tri viteve të kryhet rregullimi i shtratit të lumit Bistrica, që fillon prej Pjetërçit të Epërm e deri te Grabanica. Këto dy kërkesa i them kështu me krejt kuptimin e fjalës, e keni për obligim që asaj pjese të ju ndihmoni për shkak se aty është toka më pjellore që ekziston. E kam edhe një njoftim; ka rënë koincidence, kryesuesi kur e ka caktuar datën për debat, nuk e ka menduar me siguri, por, sot është një datë historike për Klinën, për shkak se pikërisht sot 33 vite, më 27 qershor të vitit 1990 ish-delegatët e Kuvendit Komunal të Klinës, kemi organizuar pushtetin paralel, dhe në saje të asaj kemi nxjerr konkluzionet e Kuvendit Komunal të Klinës prej 5 pikave të cilat i kemi dërguar në Prishtinë në Kuvendin e ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, dhe ato konkluzione kishin të bëjnë me gjendjen e sigurisë që ishte e vështirë në Kosovë. Pos tjerave, kemi kërkuar që delegatët të kenë mbështetjen nga qytetarët e Klinës që sa më shpejt të jetë e mundur ta shpallin Republikën e Kosovës, do të thotë 5 vite më pas është bërë

shpallja e Deklaratës Kushtetuese për Republikën e Kosovës edhe kjo është një mburrje për Klinën, sepse besoj edhe ka qenë rasti i rrallë në Kosovë që kanë ditur delegatët aq mirë të organizohen e t'i bëjnë institucionet paralele dhe do të thotë mbi 99% kanë qenë veç të larguar prej pune në këto vite, do të thotë ka qenë një unitet dhe ai unitet e sjelli këtë ku jemi. Kështu që, po them edhe njëherë duke i përshëndetur gjithë ata delegatë që kanë qenë edhe disa që tash janë gjallë, po edhe ata që s'kanë qenë, ju qoftë ndera dhe besoj që është një stimulim i mirë që edhe kjo gjeneratë e Kuvendit Komunal t'i përkrah ato që i thash më parë, për shkak se edhe si Zenun, po edhe si bashkësi lokale, edhe si mjedis, ja kemi borxh. Ju faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, është e vërtetë që nuk më është kujtuar, gjithsesi të qoftë ndera edhe ty që ke qenë pjesë e atyre delegatëve, duke ju bashkuar edhe urimit tënd për gjithë ata delegatë që e kanë nënshkruar atë deklaratë, prandaj edhe njëherë, faleminderit! Dikush tjetër? Po, urdhëro i nderuar, Elez Hoti?

Elez Hoti, Zajm: Përshëndetje të gjithëve, përshëndetje, kryetar! Unë jam Elez Hoti, me profesion inxhinier i xehetarisë, përndryshe tani në pension.

Kërkesa jonë si banorë të fshatit Zajm është kërkesë e kamotshme, lidhur me lumin Drini. Ne e dimë që edhe në vitet paraprake edhe në vitin 1983-84 fshati Zajm ka qenë i vërshuar nga uji, në prill të 2013-tës ka qenë i vërshuar se ne e kemi pasur brenda në shtëpi deri në 1.70 m, dikush edhe krejt katin e parë, edhe tash në janar ne kemi qenë në të njëjtën situatë, dmth kjo veç është kah përsëritet. Ne si qytetarë, kemi ardhur me haxhi Muhametin duke e përfaqësuar pjesën dërrmuese të fshatit, nuk po them krejt fshatin se pjesa e epërme e Zajmit nuk ka nevojë për këtë, ka nevojë për diçka tjetër më tepër, se shyqyr Zotit nuk i merr uji ata. Kërkesa jonë është që të rregullohet shtrati i Drinit prej Urës së Haxhisë deri në tregun e kafshëve. Tani për tani po shihet se vërshimet janë të mundshme prapë dhe për çdo ditë po lajmërohet se do të ketë vërshime. Prandaj, sot e pamë të arsyeshme që në këtë debat me publikun të vijmë edhe ne si qytetarë edhe t'i shprehim këto gjëra tona që po na mundojnë më së shumti për momentin, se çdo 4-5 vite duhet me rregulluar nga një kat shtëpie, kështu që, kaq, më tepër nuk kam për momentin.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit i nderuar, fjalën e ka kryetari i komunës.

Zenun Elezaj, kryetar i komunës së Klinës: Faleminderit, kryesues, përshëndetje për të gjithë ju që jeni prezent! Po mundohemi pak interaktive të bëjmë bisedën, urime Zenun për përvjetorin e deklaratës edhe gjithë atyre që kanë qenë pjesë e këtij aktiviteti të rëndësishëm.

Po ndërlidhem me kërkesat tuaja, kërkesa shumë e drejtë për mosrënimin e shkollës, ka qenë edhe ideja e Drejtorisë së Arsimit që të përdoret për ndonjë funksion tjetër që sigurisht në bashkëpunim me qytetarët është kërkesë e drejtë që do të realizohet.

Për rregullimin e shtratit të Bistricës, realisht ne kemi paraparë në buxhet dhe në vitin 2024 dhe vitin e ardhshëm janë të parapara 80,000 euro, në vitin 2025 janë të parapara 150,000 euro dhe në vitin 2026 janë të parapara 100,000 euro. Pra, që nga viti i ardhshëm do të fillojë sanimi, por që unë jam në një kërkesë të një takimi me ministrin e Infrastrukturës sepse është një kosto shumë e madhe, është një projekt shumë i madh që kjo vlen edhe për Drinin e Bardh. Kam kërkuar edhe takim me shkrim edhe duke shfrytëzuar edhe situatën që e pat Peja, pra, edhe këtë fatkeqësi që ne e bashkëndojmë me qytetarët e Pejës edhe për dëmet edhe për humbjen e jetëve.

Po besoj që do të kemi një plotësim të projektit, po në vitet në vijim kjo mund të rritet vlera, varësisht prej projekti i cili do të hartohet këtë vit dhe do të fillohet të implementohet vitin e ardhshëm.

Po ndërlihem me kërkesën e Elezit , për Drinin e Bardhë edhe këtë vit e kemi paraparë mu atë pjesën e juaj me sanuar, e kemi një fond por që e kam ndërlihur me një takim të mundshëm me ministrin edhe me një bashkëfinancim që besoj shumë shpejt të ndodh për Drinin e Bardh, sepse kemi probleme të mëdha risk madh të vërshimeve aty te ju, risk madh te Ura e Haxhisë, po edhe në pjesë tjera te Guri i Zi që është e vazhdueshme. Gjithashtu janë të parapara edhe me buxhet të vitit të ardhshëm, këtë vit i kemi 50,000 euro që mendojmë me sanuar argjaturën e asaj pjese të juaj. Meqenëse kam qenë edhe dëshmitar edhe pjesë e aktivitetit bashkë me fshatarë, me banorë të vërshimeve të janarit, jemi në pritje të kompensimit edhe të dëmeve nga Qeveria sepse raporti është hartuar nga Komisioni, është aprovuar nga Kuvendi Komunal, ka shkuar në Qeveri, po presim që së shpejti Qeveria të ndajë kompensim edhe për dëme të qytetarëve që kanë pësuar në rastin e vërshimeve, po të jetë në kuadër të infrastrukturës, sepse komuna buxhetin për vitin 2023 e ka aprovuar në shtator të vitit të kaluar, ka mundësi lëvizje të vogla, po nuk ka mundësi ndryshimet të mëdha buxhetore.

Për Drinin e Bardhë, gjithashtu janë paraparë për vitin e ardhshëm edhe 70,000 euro, 180,000 në vitin 2025, 150,000 në vitin 2026 që janë parashikime që ne mendojmë me kapacitete që i ka Klina, pra, rreth 400,000 euro diku investim për tri vite me i pasur edhe në Drinin e Bardh edhe në Bistricë.

Gjithashtu, lumi Klina do të vazhdojë ndërtimin e profilit, meqenëse e mora fjalën, është profili i njëjtë i cili ka vazhduar vitin e kaluar, do të vazhdojë këtë vit edhe vitin e ardhshëm me një vlerë 650,000 euro, deri te Jarina. Jemi në hartim të projektit për shtigjet e ecjes dhe rregullimin e shtratit të lumit deri në fshatin Pogragjë edhe do të parashikohen këtë vit, vetëm të shpallet tenderi për projekt edhe vepra inxhinierike, siç janë: urat, ura e fshatit Pogragjë, që është stabile por është në nivel të ulët, dhe në reshjet më të vogla menjëherë po vërshohet dhe qytetarët nuk po kanë mundësi të lëvizjes, faleminderit shumë!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, kryetar! Po, urdhëro, Muhamet Foniqi?

Muhamet Foniqi, Zajm: Ju përshëndes juve edhe publikun!

Jam nga fshati Zajm, kryetari e di në detaje hallin tonë, shumë mirë e tha edhe Elezi në pika të shkurtra. Ajo pjesë e mollëve që është me u bashkuar me tregun , se te tregu është shumë mirë me u bashkuar, prej aty është diku 100 metra. Unë kryetarin e kisha lutur që të na bëjë zgjidhje, nëse s'rregullohet ajo pjesë, nuk kemi çka rrimë në Zajm, se mund të ndodhin prapë vërshime.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, urdhëro kryetar?

Zenun Elezaj, kryetar i komunës së Klinës: Muhamet, e thash edhe më parë se mu ajo pjesë që po thua ti, te mollët, është projekt që ne tash i fillojmë procedurat edhe deri kah fundi i gushtit kur është koha pak më e mirë, ka për të përfunduar. Realisht është edhe shqetësim i imi edhe e njoh situatën shumë mirë aty edhe komplet jemi të angazhuar për ta rregulluar. Ajo pjesë është prioritet, prej mollëve që po thua aty e deri te tregu edhe sa të mundemi me mbërrij, sa kemi mjete. I kemi 50.000 euro, besoj që atë pjesë e kryej, tjerat çka na dalin më andej, ajo është

prioritet i yni sepse mundësia e dëmtimit të popullatës në Zajm është e mbipopulluar edhe dëmet janë shumë të mëdha. Ne e shohim si një risk shumë të madh dhe jemi të fokusuar me ato të parat çka i kemi njëherë me kryer atë pjesë, dmth kryhet sivjet kështu. Shpresoj të jemi shëndosh!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit i nderuar kryetar, dikush tjetër?

Labinot Zogaj, Zajm: Përshëndetje për të gjithë dhe për kryetarin! Unë jam Labinot Zogaj nga Zajmi, i kemi dy probleme të vogla, po njëherë na ka premtuar kryetari që ka me rregulluar, për kanalizim, tash po presim kur po fillojnë punimet. Shqetësimi i tjetër është unë udhëtoj 3-4 herë në ditë se i dërgoj fëmijët në shkollë prej Zajmit, aty ku është ferma e lopëve, jashtëqitjet i qesin në asfalt edhe era është dërrmuese. E ka postuar Klina.info para 2-3 ditëve, po ju kisha lutur me bërë një zgjidhje edhe kryetari edhe inspektorët, kush është përgjegjës, meqenëse nuk është larg për me vënë në kanalizim aty, se shumë afër e ka, po përmbi tri vite i ka që rrjedh kanalizimi i kafshëve aty në asfalt edhe dy rrjedha i ka te një kthesë aty edhe është problem serioz. Tash është vera, dhe prej temperaturave të larta po ka erë dërrmuese, faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, po, urdhëro kryetar?

Zenun Elezaj, kryetar i komunës së Klinës: Po, Labinot, kanalizimi besoj që këto ditë fillon, kompania e ka firmosur kontratën, kryhet. Për këtë problem edhe unë po i njoftoj inspektoratin, shkon e bën një inspektim edhe sigurisht që do të merren masat e nevojshme. Realisht nuk lejohet përzierja e atyre mbetjeve me kanalizim të fshatit, por sidoqoftë këto objekte i kanë lejet e veçanta, e kanë të detyruar m'i trajtuar ato pjesë sipas normave ligjore. Mundësisht kjo është sa për informim për gjithë qytetarët në raste të tilla, se kemi edhe një kërkesë te Inspektorati sepse Inspektorati i Komunës është i obliguar të dalë me bërë vizitën edhe me konstatuar gjendjen edhe faktikisht me gjetur fajtorin.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, kryetar, a ka dikush tjetër? Po, urdhëro, Idriz?

Idriz Desku: Përshëndetje, unë jam Idriz Desku, desha vetëm të ju falënderoj, se te ura e Haxhisë, aty është bërë një rregullim i shtratit të lumit Drini i Bardhë edhe lumit Klina. Ne jemi mirënjohës për punën që e keni bërë, shpresojmë që vitin e ardhshëm dhe vitet në vijim mos të kemi më vërshime në atë pjesë, kaq pata.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, Idriz, a ka dikush tjetër?

Muhamet Foniqi, Zajm: Nëse ekziston mundësia që foli Idrizi, ajo kompani që e ka rregulluar kah ata, nëse ka mundësi, ata me na sjellë, se unë i njoh, shumë mirë e kanë rregulluar pjesën e tyre. Me qenë ajo kompani me e rregulluar qysh e ka rregulluar aty, ne shpëtojmë, e jo kompania me na ardhur edhe mos me na kryer si duhet, ju falënderoj!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit shumë, baci Muhamet, dikush tjetër? Urdhëro, Faton Berisha?

Faton Berisha, Dush: Përshëndetje, unë jam Faton Berisha, përfaqësues i fshatit Dush. Përshëndetje kryetar, kryesues, nënkryetare, drejtorë, bashkëqytetarë të komunës së Klinës! Unë i kam vetëm dy kërkesa për fshatin Dush: është ndriçimi fshatit edhe kanali i ujit deri aty ku e keni bërë impiantin me livadhe edhe i kemi disa prishje të rrugës, nëse do të kishte mundësi që të na rregulloni, faleminderit edhe njëherë!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, po, kryetar?

Zenun Elezaj, kryetar i komunës së Klinës: Faton, për ndriçimin jemi duke e shpallur një procedurë të re edhe Dushi është i përfshirë në këtë procedurë të re, besoj shpejt me procedura të prokurimit edhe nja dy muaji duhet me llogaritur që i marrim, por diku muajin gusht fillon. Është fat i madh që është rregulluar impianti për trajtimin e ujërave të zeza, edhe këtë kërkesë edhe atë për sanimin e gropave tash do të fillojmë shtrimin e shtresës, do të vazhdojmë shtrimin e shtresës së rrugës nga fshati Volljakë deri në Sferkë. Po besoj që ajo pjesë ku përfshihet rruga kryesore, kanë m'u sanuar gropat edhe ka m'u shtruar një shtresë e re, edhe po vazhdon projekti edhe në sanimin e gropave aty, gjithsesi.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, kryetar, dikush tjetër? Nëse s'ka, unë ju falënderoj shumë për prezencë, faleminderit shumë që na keni pasuruar, na keni propozuar, sugjeruar, falënderoj kryetarin bashkë me nënkryetaren, drejtorët për gatishmërinë e ofrimit të zgjidhjeve të nevojave tuaja. Faleminderit shumë!

**Procesmbajtësja,
Monika Palushi**

Monika Palushi



**KRYESUESI,
Fadil Gashi**

Fadil Gashi